



Pranuar / Dorezuar Prilipim/Prodato Received/Delivered	23.06.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohëzma Quantity
SKANSHEK	1895/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.756/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.756/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër masës disiplinore vërejtje të datës 02.05.2023 të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit të Rimbursimeve në Administratën Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 23.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet masa disiplinore “Vërejtje” e datës 02.05.2023 e shqiptuar Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit të Rimbursimeve në Administratën Tatimore të Kosovës ndaj ankuesit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerrë aktin e kontestuar administrativ.

II. Obligohet Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit për Rimbursime në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të ankuesit dhe të veproj në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ i punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr. 143/2022 të datës 31.12.2020 në pozitën Zyrtar i Lartë për Rimbursime në Administratën Tatimore të Kosovës, zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit për Rimbursime më datë 02.05.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje", me arsyetimin se: 1. pasi që nga kërkesat e mija në vazhdimësi për ndjekjen e procedurave, zbatim të ligjit, respektim të afateve të trajtimit të rimbursimeve nuk i ka respektuar. 2. Gjatë shqyrtimit të lëndëve aprovon dhe refuzon pa bazë ligjore lëndët e rimbursimit dhe për këtë arsye edhe i Kthen lëndët prapë në rishqyrtim për sqarim të atyre gabimeve dhe prap vepron njëjtë. 3. Për mos respektim të procedurave ligjore, për mos bashkëpunim, për aprovim/refuzim të lëndëve pa bazë të njaftueshme ligjore gjatë shqyrtimit të lëndëve, për vonesa në shqyrtimin e lëndëve të rimbursimit, për mos informim me kohë të tatimpaguesit me rastin e refuzimit të lëndëve të rimbursimeve. Prandaj për mosveprime në respektim të kërkesave të qarta të mia si zv. I Divizionit të Rimbursimeve dhe ngecja e respektimit të procedurave ligjore duke u mbështetur në legjislacionin aktual, procedurat tjera si dhe mbështetur në Nenin 47 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i shqiptohet kjo masë.

Ankuesi, kundër masës disiplinore vërejtje të datës 02.05.2023, më datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4329/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 26.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4329/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen e datës 02.05.2023; Emailin e datës 28.04.2023 nga ankuesi për _____ Emailin e datës 28.04.2023 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 27.04.2023 nga ankuesi për _____ Emailin e datës 27.04.2023 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 26.04.2023 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 26.04.2023 nga ankuesi për _____ Emailin e datës 25.04.2023, 02.02.2023 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 28.04.2023 nga _____ për _____ ; Shkresë me numër Reference 128/2023 për Kategorizimin e Subjekteve në Kategorisë C e datës 24.04.2023; Emailin e datës 20.04.2023 nga ankuesi për _____ Emailin e datës 20.04.2023 nga _____ për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.05.2023; Akt Emetimin _____ Nr.143/2022 i datës 31.12.2022; Vendimin me Nr. 143/2022 i datës 20.12.2022; Formularin i Përshkrimit të detyrave të Punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Rimbursime; Emailin e datës 24.05.2023 nga _____ për V.S; Emailin e datës 24.05.2023 nga _____ për _____ Rasti 20465; Shkresë me titull Rimbursimi i Subjektit "BDE CENTER shpk" e datës 30.03.2023; Detajet e vlerësimit për BDE CENTER SHPK; Shkresë me titull Rimbursimi i subjektit "BDE

CENTER shpk" e datës 31.03.2023; Detajet e vlerësimi për BDE CENTER SHPK; Certifikata e mbajtjes në burim të tatimit mbi interesin, të drejtat pronësorë, Qiratë jo-rezidentët dhe kategorisë të Veçanta për KAN Shpk, SPORT IN SHPK, PC.COMP SH.P.K, Kërkesë për Procedim të Rimbursimit në TVSH e datës 09.02.2023; Certifikatë e Regjistrimit e datës 08.03.2019; Konfrimim bankar; Formular për regjistrim të furnitorit; Emailin e datës 23.03.2023 nga për ankuesin; Kërkesë për procedim të furnitorit e datës 10.02.2023; Kërkesë për procedim dhe rimbursim Tatimor e datës 10.02.2023; Emailin e datës 18.04.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 10.02.2023 nga për Formën e vizitës së përmbushjes e datës 13.02.2023, 09.02.2023; Kontratë Pune e datës 24.11.2014; Librezë nga HANDIKOS; Vërtetim nga HANDIKOS-Pejë e datës 20.11.2019; Certifikatën e Kontributit Pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga e datës 06.02.2023; Emailin e datës 25.05.2023 nga për ; Emailin e datës 05.04.2023 nga për ankuesin; Emailin e datës 05.04.2023 nga ankuesi për Emailin e datës 31.03.2023 nga për ankuesin; Shkresën për rimbursim të subjektit "Posta e Kosovës SHA" e datës 30.03.2023; Detajet e Vlerësimit për Posta e Kosovës SHA; Shkresën për rimbursim të subjektit "Posta e Kosovës SHA" e datës 02.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankuesit sipas ankesës më numër 756/2023 të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi që ka nxjerr aktin juridik të kontestuar, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore vërejtje të datës 02.05.2023, pretendon që kjo masë është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë shkelja disiplinore por vetëm i është referuar nenit 46 pa përcaktuar se cilat paragrafë të këtij neni janë shkelur dhe nuk është specifikuar saktë shkelja e bërë.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht: nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: "... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë,

institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar, nenit 47 paragrafit 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.

Kolegji i Këshillit për shqyrtim të drejtë të kësaj çështje mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me theks të veçantë dispozitat e nenit 7 dhe 8 të kësaj rregullore ku përcaktohet se: **Neni 7 Fillimi i procedurës disiplinore** 1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë. 2. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore brenda afateve të përcaktuara në nenin 48 paragrafin 7 të Ligjit. 7. Komisioni disiplinor fillon procedurën disiplinore edhe në rastet kur paraqiten elementet e përcaktuara në nenin 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 dhe 4.3 të Ligjit. **Neni 8 Kompetenca për masat disiplinore** 1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit. 3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligji. 4. Masat disiplinore vendosen dhe regjistrohen në dosjen personale të nëpunësit".

Referuar dispozitave të lartcekura si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje" e datës 02.05.2023, Kolegji i Këshillit, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, masën disiplinore të kontestuar me këtë ankesë e ka shqiptuar duke u thirrur në nenin 46, nenin 47 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa nuk ka arritur të bëjë kualifikimin e shkeljeve disiplinore (a janë shkelje të rënda apo të lehta) dhe të konstatoj në mënyrë të drejtë se cilat dispozita ligjore janë cenuar me veprimet e nëpunësit civil respektivisht ankuesit, ndërsa në rastin konkret të ankuesit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk ka ndërmarr veprimet e tilla duke bërë kualifikim paushall të shkeljes disiplinore, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj mase nënkuptohet që e njëjta është shqiptuar për shkak të mos respektimit të afateve për trajtimin e rasteve, mos trajtimin e rasteve, shqyrtimi i lëndëve pa bazë ligjore dhe për

mos respektim të procedurave dhe mos bashkëpunim, e në fakt këto nuk konsiderohen shkelje të lehta disiplinore e për të cilat nuk mund të shqiptohet masë disiplinore vërejtje.

Andaj, duke qenë se masa disiplinore "Vërejtje" e datës 02.05.2023 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit për Rimbursime ndaj ankuesit, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që çështja të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, me detyrimin që Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit për Rimbursime në Administratën Tatimore të Kosovës, brenda afatit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj çështje disiplinore dhe të veprojnë në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 3, 4, 5, dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *... "Nëse njoftimi i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore, duke e arsyetuar me shkrim mos fillimin e procedurës dhe për këtë e njofton paraqitësin e shkeljes së pretenduar përmes njoftimit formal sikurse që përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit. Pra mbikëqyrësi i ankuesit në rast të kualifikimit se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore duhet të shqiptoj masën disiplinore sipas nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ose në rast të kualifikimit se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore atëherë rastin duhet ta përcjell për Komisionin Disiplinor të ATK-së në pajtim me nenin 7 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.756/2023, datë 23/06/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Divizionit për Rimbursime në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.